


**EC**  
MA NDËRYSHE



TETOR

2  
0  
2  
0

# HAPËSIRAT PUBLIKE GJELBËRUESE

FERIZAJ



EC Ma Ndryshe

# HAPËSIRAT PUBLIKE GJELBËRUESE NË FERIZAJ

Autor dhe botues: EC Ma ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren &  
Bulevardi Nënë Tereza 30B H1 Nr.5, Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
029 222 771 & 038 224 967

Hulumtimi “Hapësirat publike gjelbëruese në Ferizaj” është realizuar nga EC Ma Ndryshe, i cili mbështetet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, (Sida) përmes Programit të saj “Human Rightivism” që implementohet nga Community Development Fund – CDF. Përmbajtja dhe qëndrimet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtarë të donatorëve.

Tetor, 2020

Hapësirat publike si zonë e përbashkët e gjithë shoqërisë të cilat plotësojnë nevojat fizike, perceptuese dhe shoqërore të njerëzve janë treguesi më i madh i imazhit urban. Sheshet dhe rrugët që sigurojnë transportin janë bartësit e trashëgimisë kulturore që shërbejnë si një pikë e jetës urbane me kujtimet që një qytet ka akumuluar ndër vite.


Sheshet gjithashtu kanë efektin e krijimit të një imazhi për qytetin duke pasqyruar identitetin e tij. Si pjesë e jetës në sheshet dhe rrugët e qytetit, njerëzit merren me aktivitete fizike dhe shoqërore. Sidoqoftë, në pikën që kemi arritur sot, këto zona janë të okupuara nga trafiku i madh dhe të rrethuara nga ndërtesa.

Si në shumë vende të botës edhe në qytetet e Kosovë, hapësirat publike përveç që nuk janë të mjaftueshme e jo gjithëpërfshirëse por janë edhe gjithmonë të uzurpuara dhe jo të përshtatshme për lëvizje të lirë.


Duke e parë me shqetësim këtë situatë të rinjtë e Komunës së Ferizajit si problem për bllokim të hapësirave publike e kanë parë dhe mungesën e shtigjeve dhe parkingjeve të biçikletave. Pas takimeve me të rinjtë e kësaj Komune, EC e ka parë të arsyeshme të bëjë një hulumtim të përgjithshëm rreth hapësirave publike dhe gjelbëruese në qytetin e Ferizajit me qëllim të identifikimit të numrit të hapësirave publike, qasjes së persovave me aftësi të kufizuara, gjendjes së mjedisit në këto hapësira dhe me theks të veçantë mungesës së shtigjeve dhe parkingjeve për biçikleta.

Në këtë hulumtim kanë marrë pjesë 118 persona nga të cilët 47 gra dhe 71 burra.

Paraqitja grafike e të dhënave të hulumtimit është në vijim.




## 02 1. SA SHPESH I FREKUENTONI PARQET PUBLIKE ?



### PËRMBLEDHJE:

Shumica e të anketuarve janë përgjigjur që i frekuentojnë parqet publike shpesh dhe rregullisht, ndërsa asnjë nuk është përgjigjur që nuk i frekuentojnë asnjëherë. Burrat janë shprehur se i frekuentojnë rregullisht, ndërsa gratë shpeshherë dhe grupmosha 45+ janë shprehur si frekuentuesit më të shpeshtë.


## 2. A MENDONI SE KA MJAFTUESHËM HAPËSIRA PUBLIKE TË GJELBËRUARA NË QYTET ?



### PËRMBLEDHJE:

Shumica e të anketuarve, gjegjësisht 58.5% e tyre, janë shprehur se ka nevojë deri diku për më shumë hapësira publike të gjelbëruara. Burrat janë përgjigjur me “po” (29.6%) dhe “deri diku” (53.5%) në këtë pyetje, ndërsa gratë janë përgjigjur me “po” më pak (8.5%) dhe me “deri diku” më shumë se burrat (66%). Pothuajse të gjitha grupmoshat janë shprehur në përqindjen e njëjtë.


### 3. A JANË TË MJAFTUESHME DHE TË MIRËMBAJTURA ULËSET DHE SHPORTAT E MBETURINAVE NËPËR PARQE DHE HAPËSIRA PUBLIKE?



#### PËRMBLEDHJE:

50.8% e të anketuarve janë shprehur se ka mjaftueshëm ulëse dhe shporta të mbeturinave nëpër parqe, mirëpo janë të dëmtuara. Burrat dhe gratë janë shprehur përafërsisht njëllor, me dallim të vogël në përqindje (46.5%/57.4%). Grupmoshat kanë pasur dallim në mendim, me grupmoshat më të reja që kanë qenë të mendimit se shumica janë të dëmtuara, dhe grupmoshat më të vjetra që janë shprehur se janë në nivelin e duhur.


### 4. A MENDONI SE NDRIÇIMI NË PARQE DHE HAPËSIRA PUBLIKE ËSHTË I MJAFTUESHËM ?



#### PËRMBLEDHJE:

Shumica e të anketuarve (59.3%) janë shprehur se ndriçimi në parqe dhe hapësira publike është deri diku i mjaftueshëm. Gratë janë shprehur në një përqindje më të lartë se burrat rreth kësaj çështjeje (68.1%). Moshat e vjetra janë prononcuar më shumë me përgjigjet se ndriçimi është i pamjaftueshëm, dhe se është i mjaftueshëm deri diku.


## 5. SA JANË TË QASSHME PARQET DHE HAPËSIRAT PUBLIKE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR ?



### PËRMBLEDHJE:

Të anketuarit janë shprehur se parqet dhe hapësirat publike janë pjesërisht të qasshme dhe të qasshme vetëm me përcjellje për personat me aftësi të kufizuara. 53.5% e burrave kanë thënë se janë pjesërisht të qasshme dhe 68.1% të grave. Shumica e grupmoshave janë prononcuar njëjloj- të qasshme vetëm me përcjellje, sidomos grupmoshat e vjetra.


## 6. A EKZISTON RREZIKU NGA QENTË ENDACAK NË PARKUN E LAGJES DHE HAPËSIRAT PUBLIKE ?



### PËRMBLEDHJE:

78% të të anketuarve janë shprehur se ekziston rrezik nga qentë në parqet e lagjeve të tyre dhe në hapësirat publike, me përqindje të lartë në përgjigje nga të dyja gjinitë dhe nga të gjitha grupmoshat.


## 7. A JENI PËRDORUES TË BIÇIKLETËS? NËSE PO: SA SHPESH E PËRDORNI BIÇIKLETËN:



## PËRMBLEDHJE:


Shumica e të anketuarve janë shprehur se janë përdorues të biçikletës, ndër ta 36% e përdorin shpesh, dhe 39% e përdorin rrallë. Ndërsa gratë dhe burrat janë shprehur pothuajse njëjtë në atë se sa e përdorin biçikletën, me grupmoshat e vjetra që e përdorin më shumë (50% e tyre 64+).

## 8. BIÇIKLETËN MË SHUMË E PËRDORI PËR:



## PËRMBLEDHJE:


Shumica e të anketuarve (77%) janë shprehur se e përdorin biçikletën më shumë për rekreacion/aktivitet fizik. Ndër to, të dyja gjinitë janë shprehur në përqindje të lartë se e përdorin biçikletën dhe të gjitha grupmoshat, sidomos ato më të vjetra.



**PËRMBLEDHJE:**

48% e të anketuarve janë shprehur se përdorimi më i madh i biçikletave do të ndikonte në përmirësimin e shëndetit personal (42% burra, 55% gra) dhe 43% janë shprehur se do të ndikonte në uljen e ndotjes së ajrit nga përdorimi i automjeteve (45% burra dhe 40% gra). Grupmoshat më të vjetra janë përgjigjur më së shumti se do të ndikonte në përmirësimin e shëndetit personal.

10. SA MENDONI SE KA NEVOJË QYTETI I FERIZAJIT PËR SHTIGJE TË BIÇIKLETAVE ?




**PËRMBLEDHJE:**

Ndër të anketuarit shumica e tyre (56%) janë shprehur se qyteti i Ferizajit ka nevojë për shtigje të biçikletave, me përqindje më të lartë në nivelin e nevojshëm të shprehur si “mesatarisht” nga dyja gjinitë (55% burra, 64% gra). Grupmosha 45-54 janë përgjigjur më shumë me “mesatarisht”, ndërsa grupmosha 64+ janë përgjigjur se ka nevojë shumë, pasi që Ferizaji nuk ka hapësira adekuate për biçikleta.



## 11. CILA NGA ARSYET E MËPOSHTME NDIKON MË SHUMË NË MOSPËRDORIMIN E BIÇIKLETAVE NGA JU:


7



### PËRMBLEDHJE:

Të anketuarit janë shprehur se mungesa e shtigjeve (21%) dhe parkingjeve për biçikleta (51%) i shtyn të mos përdorin biçikletat. Burrat dhe gratë janë përgjigjur pothuajse njëloj në përqindje dhe grupmoshat më të reja dhe më të vjetra janë shprehur zëshëm për mungesën e parkingjeve, dhe problemin që paraqet në përdorimin e biçikletave.


## 12. SA ANËTARË TË FAMILJES TUAJ PËRDORIN BIÇIKLETA ?



### PËRMBLEDHJE:

Në këtë pyetje, 49% të qytetarëve janë përgjigjur se vetëm 1 person në familjen e tyre përdorë biçikletë, ndërsa 19% e tyre janë përgjigjur me asnjë. Gratë janë shprehur si përdoruese pak më të mëdha se burrat dhe qytetarët e grupmoshave 45+.


### 13. A MENDONI SE VENDOSJA E PARKINGJEVE TË BIÇIKLETAVE NË HAPËSIRA PUBLIKE (SHKOLLA, PARQE, INSTITUCIONE ETJ..)DO TA SHYNTONTE PËRDORIMIN E BIÇIKLETAVE SI MJET TRANSPORTUES ?



#### PËRMBLEDHJE:

56% e të anketuarve janë përgjigjur se vendosja e parkingjeve të biçikletave do t'i shtynte në përdorimin më të madh të biçikletës. Burrat dhe gratë janë shprehur në përqindje të njëjtë, ndërsa grupmoshat më të vjetra janë shprehur më zëshëm.


### 14. BIÇIKLETEN PREFEROJ TA PËRDORI BASHKË ME FAMILJE.



#### PËRMBLEDHJE:

68% të qytetarëve janë shprehur se nuk preferojnë ta përdorin biçikletën bashkë me familje: gratë dhe burrat janë shprehur pothuajse njëjloj, me mendim pothuajse të njëjtë nga të gjitha grupmoshat.

## 15. A JENI FTUAR NDONJËHERË NGA INSTITUCIONET KOMUNALE PËR TË DISKUTUAR DHE OFRUAR PROPOZIME RRETH HAPËSIRAVE GJELBËRUESE NË QYTET?



### PËRMBLEDHJE:

Përqindja më e lartë e qytetarëve (66.9%) janë shprehur se nuk janë ftuar asnjëherë nga institucionet komunale për të diskutuar dhe ofruar propozimet e tyre rreth hapësirave gjelbëruese në qytet. Gratë dhe burrat janë përgjigjur në përqindje të ngjashme dhe shumica e grupmoshave, sidomos ato më të vjetrat, janë shprehur njëjloj.

## 03 REKOMANDIME

Hapësirat publike gjelbëruese nuk mund të jenë funksionale pa ulëse dhe shporta të mbeturinave në numrin dhe nivelin e duhur. Duke u bazuar në statistikave të nxjerra, ne rekomandojmë që ulëset dhe shportat e mbeturinave që janë ekzistente të mirëmbahen nga organet përgjegjëse, dhe sipas nevojës të shtohen aty ku janë të nevojshme. Komuna rekomandohet të identifikoj numrin e ulëseve të dëmtuara dhe atyre që mungojnë dhe në bazë të një planifikimi që do të dal nga ky inventarizim të vendosen ulëset e reja në këto parqe.



Sipas statistikave të nxjerra, personave me aftësi të kufizuara dukshëm ju mungon pavarësia në lëvizje të lirë. Ne duam të vëmë në pah që në mënyrë që një qytet të jetë gjithëpërfshirës, duhet të mendohen të gjitha grupet e shoqërisë, e sidomos ato të marginalizuara, në planifikim hapësinor urban. Rekomandohen institucionet kompetente të bashkëpunojnë me qytetarët, duke i marrë kërkesat e tyre parasysh në planifikim, e më pas ndërmarrin veprime konkrete në realizimin e një hapësire jetësore të përshtatshme për të gjithë.



Siguria e qytetarëve në hapësira publike duhet të jetë ndër pikat kryesore për organet qeverisëse, si dhe trajtimi i çështjes së qenve endacakë etikisht dhe sipas ligjit. Rekomandojmë që duke e marrë për bazë përgjigjen e qytetarëve se ka rrezik nga qentë endacakë, të ndërmerren hapa konkretë nga organet përgjegjëse për trajtimin e këtij problemi.



## 03 REKOMANDIME

Pavarësisht përdorimit të madh të biçikletave, ende nuk ka shtigje dhe parkingje të dedikuara për biçikleta. Është shfaqur në të gjetura që qytetarët kanë vullnet dhe dëshirë që të përdorin biçikletë, mirëpo këtë mjet e përdorin vetëm në situata të lejuara infrastrukturore. Rekomandohet që të promovohet më shumë përdorimi i biçikletës për transport si dhe të krijohen kushte më të përshtatshme për ngasje të biçikletës. Përdorimi më i shpeshtë i biçikletës do të reduktonte përdorimin e mjeteve të tjera të transportit publik (makinave, taksive, autobusëve), duke ulur në këtë mënyrë konsumin e karburanteve dhe prodhimin e dioksidit të karbonit e në këtë mënyrë do të ndihmonte në ulje të ndotjes dhe përmirësim të shëndetit publik. Për çdo 1 kilometër që përshkohet me biçikletë në vend të automjetit parandalohet emetimi në natyrë i 145 gram dioksid karboni (CO<sub>2</sub>). Përhapja e përdorimit të biçikletës është shumë e dobishme si në aspektin mjedisor ashtu edhe atë shëndetësor dhe social për një mjedis dhe shoqëri. ■■■■■



Mungesa e shtigjeve dhe parkingjeve për biçikleta, trafiku i dendur dhe rrugët e pasigurta janë faktorët kryesor që ndikojnë në mospërdorim të biçikletave.

Rekomandojmë që Komuna ta krijojë një plan të mobilitetit përmes të cilit të shtohen parkingjet dhe shtigjet për biçikleta, në mënyrë që qytetarëve t'iu krijohet hapësirë për eliminim të përdorimit të veturave e në vend të tyre të kenë alternativën e biçikletës për transport, e që kjo do të shoqërohej edhe me trafik më të lirë.

Mosekzistimi i vendeve të posaçme për parkim të biçikletave është një nga problemet që ngasësve iu ndalon përdorimin sa më të shpeshtë të tyre si mjet transportues. Në çdo rrugë që dalim me çfarëdo mjet transportues në qytetet tona, si problem na paraqitet një vendparkim i sigurtë i tyre. Kështu që institucionet për të inkurajuar apo nxitur qytetarët për përdorim të biçikletave duhet të ndërtojnë edhe parkingje në vende të ndryshme të qytetit. ■■■■■



Rekomandohen institucionet në rritjen e transparencës, gjithëpërfshirjes dhe hartimin e projekteve për planifikim hapësinor me pjesëmarrje nga qytetarët, në mënyrë që kërkesat dhe nevojat e qytetarëve të jenë baza e punës për ndërhyrje të çfarëdo natyre në shërbim të tyre.

## Për EC

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikqërjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore.

Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme: **1.** Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale, **2.** Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe **3.** Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta.

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 – 2024) ka këto elemente:

**1.** Gjithëpërfshirjen, **2.** Qëndrueshmërinë, dhe **3.** Dijen. EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbarshtëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga posht lart. Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

- 1.** Paanshmëria - EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion;
- 2.** Aktivizmi - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyer përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës;
- 3.** Orientimi drejt rezultateve - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura dhe
- 4.** Komuniteti bazë e veprimit - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.